



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 69/1 prot.

Tiranë, më 06. 02. 2023

V E N D I M

Nr. 23, datë 06. 02. 2023

Mbështetur në ligjin nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 10 Regj., datë 11.01.2023, që i përket ankuesit A. T., kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”¹ (IEVP 313), me pretendimin diskriminimin për shkak të *gjendjes arsimore*² dhe *përkatësisë në një grup të veçantë*³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të paraqitur në ankesë, referuar Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, A. T. është emëruar në pozicionin e Punonjësit të Rolit Bazë, pranë IEVP “Jordan Misja”. Gjatë vitit akademik 2022-2023, ankuesi ka nisur studimet me kohë të plotë në vitin e I-rë pranë Universitetit “Albanian University”, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, programi master në Teknologji Informacioni.

Për shkak se shërbimet në IEVP “Jordan Misja”, kryhen në sistemin 12 orë, ai e ka të pamundur të ndjek studimet e nisura. Në këto kushte, më datë 21.11.2022, i është drejtuar punëdhënësit me shkresë zyrtare, ku ka kërkuar kryerjen e shërbimit në sistemin 8 orë, në mënyrë që të mund të vijoj të ndjek studimet. Duke qenë se ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje sa i përket shkresës së sipër cituar, me datë 10.01.2023, i është drejtuar sërish punëdhënësit me të njëjtën kërkesë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin IEVP “Jordan Misja”.

² Referuar informacionit të dhënë, ankuesi vijon studimet në programin Master, në degën e Inxhinierisë

³ Referuar Autorizimit Nr. 37/9-11/2022 prot., datë 23.11.2022, lëshuar nga Sindikata e Shërbimeve Policore të Shqipërisë, ankuesi është përfaqësues i saj në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se po diskriminohet nga punëdhënësi për shkak të gjendjes arsimore dhe faktit që ai është përfaqësues i Sindikatës së Shërbimeve Policore të Shqipërisë në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë. Në këto kushte, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese nga ana e IEVP “Jordan Misja” dhe të rekomandohet rregullimi i situatës duke bërë të mundur kryerjen e shërbimit 8 orë, në mënyrë që të ndjek studimet e nisura.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7/1 i LMD-së⁴, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim, ankuesi me e-mail-in datë 31.01.2023, të dërguar në adresën e KMD-së, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi problemi i tij ka marrë zgjidhje, duke ju kërkuar ndjesë nga ana e punëdhënësit për situatën e krijuar dhe i është ofruar vazhdimi i shërbimit në mënyrë që të mos pengohet në të drejtën për tu arsimuar.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura*

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga A. T., i cili me anë të kërkesës me e-mail, datë 31.01.2023 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 10, datë 11.01.2023, të paraqitur nga A. T., kundër IEVP “Jordan Misja” Tiranë, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore dhe përkatësia në një grup të veçantë)
(Fusha: Punësim)